



## URDHËR

Nr. 81, Datë 26 /10/2016

### **MBI PËRZGJEDHJEN E PERSONELIT AKADEMIK ME KOHËZGJATJE TË CAKTUAR DHE ME ANGAZHIM ME KOHË TË PJESSHME NË UNIVERSITETIN E ARTEVE PËR VITIN AKADEMIK 2016 - 2017**

Në zbatim të, nenit 3, (*Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë*), neni 39 (*Rektori*), neni 57 (*Personeli i institucioneve të arsimit të lartë*), neni 59 (*Kategoritë e personelit akademik*), neni 62 (*Personeli akademik i ftuar*), neni 109 (*Burimet e financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë*), të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Kodit të Punës së RSH, VSA nr. 7 datë 14.7.2016, "Për miratimin e numrit për personelin akademik të ftuar dhe punonjësve të administratës me kontratë në Universitetin e Arteve për vitin akademik 2016-2017", VSA nr. 8 datë 14.7.2016, "Për miratimin e kriterëve të vlerësimit të kandidatëve për personel akademik i ftuar në Universitetin e Arteve për vitin akademik 2016-2017", projekt - buxhetit të vitit kalendarik 2017,

## URDHEROJ

1. Njësitë bazë (*departamentet*) në fakultetet e UART, kanë të drejtë të kërkojnë të punësohen me kontratë me kohëzgjatje të caktuar dhe me angazhim me kohë të pjesshme personel akademik për veprimtari të mësimdhënies, mbështetur në programet mësimore miratuar me VSA nr. 7 datë 14.7.2016;
2. Njësitë bazë (*departamentet*) në fakultetet e UART, përcaktojnë kriteret e punësimit të personelit akademik me kontratë me kohëzgjatje të caktuar dhe me angazhim me kohë të pjesshme, miratuar me VSA nr. 8 datë 14.7.2016;
3. Kontrata Individuale e Punës, nënshkruhet nga Rektori i UART si përfaqësues i Universitetit të Arteve dhe Personeli i akademik i ftuar, përzgjedhur nga komisioni *ad hoc*;
4. Për zgjedhjen e personelit akademik me kohëzgjatje të caktuar dhe me angazhim me kohë të pjesshme, ngrihen komisione *ad hoc*, në fakultetet e UART, duke ju përmbajtur rregullave të përgjithshme si më poshtë vijon:
  - a) Shpallja e vendeve të lira në fakultetet e Universitetit të Arteve bëhet me kërkesë të Rektorit të Universitetit të Arteve;
  - b) Njoftimi i shpalljes së vendeve të lira bëhet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve nga DMBNJ;
  - c) Komisionet *ad hoc* pranë fakulteteve ngrihen me urdhër nga Dekani i fakultetit;
  - d) Komisioni *ad hoc*, si rregull përbëhet nga pesë anëtarë, si më poshtë:
    - 1) Zv./rektori i UART në cilësinë e anëtarit të dërguar nga Rektorati;
    - 2) DMBNJ në cilësinë e anëtarit të dërguar nga Rektorati;
    - 3) Drejtuesi i njësisë Kryesore në cilësinë e Kryetarit të Komisionit;
    - 4) Drejtuesi i departamentit, ku do të bëhet punësimi në cilësinë e anëtarit;



Adresa: Biv. "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uart.edu.al

- 5) Një anëtar nga personeli akademik me titull akademik i përcaktuar nga Përgjegjësi i Departamentit dhe miratuar nga Dekani në cilësinë e anëtarit.
- 5) Komisioni ad hoc organizon, drejton dhe mbikëqyr procedurat e zhvillimit të konkurrimit, shqyrton dosjet dhe vlerëson me pikë kandidaturat e paraqitura mbi bazën e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për secilin specialitet, të përcaktuara dhe miratuar me VSA nr. 8 datë 14.7.2016;
- 6) Komisioni ad hoc ka të drejtë të intervistojë kandidatët kur e gjykon të arsyeshme. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit *ad hoc* janë përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit, duke filluar që nga marrja në dorëzim e dosjeve të kandidatëve, zhvillimi i konkurrimit e deri në shpalljen e vendimit për vlerësimin, renditjen dhe përzgjedhjen e kandidaturave.
- 7) Çdo anëtar i Komisionit *ad hoc* është i detyruar të shqyrtojë në mënyrë individuale të gjitha dosjet e prezantuara për konkurrim. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kandidaturave, Komisioni *ad hoc* merr vendim për kualifikimin ose jo të kandidatëve dhe bën renditjen e përgjithshme të kandidaturave të kualifikuara, mbi bazën e pikëve të fituara.
- 8) Vendimet e Komisionit *ad hoc* merren me shumicë votash. Anëtarët nuk lejohet të abstenojnë.
- 9) Në përfundim të procesit, Kryetari i komisionit përpilon procesverbalin dhe pas renditjes, konkurrentët që ka kanë fituar më shumë pikë i paraqiten nga Dekani, Rektorit të Universitetit të Arteve për miratim, së bashku me dosjet e kandidatëve konkurrues.
- 10) Rektori pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga Komisioni *ad hoc*, merr vendim dhe e shpall publikisht në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.
- 11) Në çdo kohë përpara shpalljes së fituesit, për shkaqe të arsyeshme dhe objektive që lidhen me zhvillimin jo korrekt të procedurave konkurruese dhe procesit të vlerësimit të kandidaturave, me vendim të arsyetuar, Rektori ka të drejtë të mos shpall fitues asnjë kandidaturë duke vendosur në të njëjtën kohë anulimin e procedurave të konkurrimit dhe përsëritjen e tyre.
- 12) Pas shpalljes së Vendimit, mbështetur në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe në Kodin e Punës, kandidatët lidhin kontratë pune me Universitetin e Arteve. Kontrata nënshkruhet nga punëmarrësi dhe Rektori.
- 13) Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Zëvendës rektori për anën mësimore, Kancelari i UART, Dekanët dhe Drejtuesit e Departamenteve në fakultete dhe DMBNJ.

**Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.**

Prof. Kastriot CAUSHI  
  
REKTOR  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
